



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 9 Prot

Tiranë, më 18/02 2013

**VENDIM Nr. 7 dt. 13.02.2013**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.02.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

**Lidhur me diskutimin e kërkesave të qytetarëve**

**VENDOSI:**

1. **Miratohet:** Restaurimi i objektit dritëshkronja Marubi, mon i kat. II, Shkodër.
  2. **Miratohet:** Projekti i ndërtimit të objektit "Dyqane + Banim", Rruga G'juhadol "Mikel Koloqi, Shkodër, me investitor, Anton Koleka.
  3. **Miratohet me shumicë votash:** Projekt restaurimi banesë 3 kate, porositës Nikolin Ujka, rruga "Kardinal Koliqi", Qendra Historike, Shkodër.
  4. **Miratohet:** Projekt restaurimi objekti banesa e Boriçëve, rikonstruksion + shtesë kati, Shkodër me vërejtjet:
    - Të ripunohet kati i parë.
    - Të hiqen mansardat.
    - Ballkonët të trajtohen në formë simetrike.
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
  - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**ALDO BUMÇI**

**SEKRETAR I KKR**  
**AKADEMIK. APOLLON BAÇE**